

MANUALI I GRANTIT

Rregullat dhe procedurat për zbatimin e skemës së nën-grantimit si pjesë e projektit në Maqedoninë e Veriut

P U L S E

Mbrojtja e Peizazheve dhe Specieve Unike në Shqipëri dhe
Maqedoninë e Veriut

Me mbështetjen financiare të PONT

Zbatuar nga CNVP Maqedonia e Veriut

Gusht 2026

Përmbajtja e Lëndës

1. Hyrje.....	3
2. Rajoni i projektit.....	4
3. Objektivat.....	5
4. Grupet e Synuara (Target Groups).....	5
5. Procedurat.....	6
6. Fazat e nën-grantimit	6
7. Llojet (tipet) e pranueshme të aksioneve të grantit në mikro rajonin "5V"	7
8. Kërkesat për Bashkëfinancim	9
9. Aplikuesit e pranueshëm për nën-grantim	10
10. Aktivitetet e papranueshme	11
11. Dorëzimi I projekt propozimeve.....	13
12. Kriteret e vlerësimit.....	13
13. Shpenzimet e pranueshme	14
14. Kontraktimi.....	15
15. Raportimi dhe Monitorimi	15
16. Ankesat.....	15
17. Shtojcat	15

1. Hyrje

CNVP është një organizatë që vepron në Rajonin e Ballkanit. Si ish-pjesë e SNV (<http://www.snv.org>), një grup inxhinierësh pyjesh të përkushtuar vendosën të themelojnë CNVP-në në korrik të vitit 2012. Nga fillimet e saj e deri më sot, ky ekip i vogël entuziastësh është rritur në 25 persona me prejardhje të ndryshme profesionale. Aktualisht, CNVP është duke zbatuar projekte në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Mal të Zi.

Pyjet janë në fokusin e CNVP-së si një nga ekosistemet më të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit, zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe zhvillimin ekonomik lokal. CNVP do të vazhdojë të punojë së bashku për të adresuar sfidat me të cilat përballet natyra dhe njerëzit në vendet në zhvillim. Duke punuar së bashku *"për të rritur një mbulueshmëri pyjore që ofron strehë, ushqim, mjete jetese dhe një vend për të ecur."* Përmes promovimit të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, CNVP u ofron mbështetje komuniteteve lokale dhe qeverive për të krijuar një jetë në harmoni me natyrën. Përmes projekteve të ndryshme, CNVP kontribuon për një Evropë më të mirë në Juglindje duke punuar në gjashtë fushat kryesore të mëposhtme:

1. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore
2. Ndryshimet klimatike
3. Zhvillimi rural
4. Energjia e rinovueshme
5. Mobilizimi i komunitetit
6. Integrimi evropian

CNVP, përmes organizatave të saj në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri, është duke zbatuar projektin tri-vjeçar "PULSE - Mbrojtja e Peizazheve dhe Specieve Unike në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut" në zonat e mbrojtura në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri (Korab-Koritnik, Sharrit dhe Alpet Shqiptare), financuar nga Prespa Ohrid Nature Trust (PONT).

Ky propozim bazohet në arritjet dhe mësimet e nxjerra nga faza e parë e projektit të zbatuar gjatë periudhës 2022-2025 dhe adreson nevojën imperative për harmonizimin e praktikave të qëndrueshme të ruajtjes së natyrës me zhvillimin socio-ekonomik në Parqet Alpet Shqiptare dhe Korab-Koritnik në Shqipëri dhe Parkun Kombëtar Mali Sharr në Maqedoninë e Veriut. Përveç kësaj, granti bazohet në përvojën e fituar nga CNVP në rajonin e Prespës, me mbështetjen e PONT, si dhe në punën e gjerë që CNVP ka kryer në vendet e Ballkanit prej shumë vitesh me mbështetjen e donatorëve të tjerë.

Aktivitetet do të fokusohen në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike të komuniteteve lokale. Ai integron mbrojtjen e biodiversitetit, ruajtjen e habitateve, pylltarinë në komunitet, praktikat agro-ekologjike dhe promovimin e ekoturizmit brenda një kuadri që lidh ruajtjen e natyrës me përfitimet ekonomike lokale.

Një program i grantit të vogël për bizneset lokale, fermat bujqësore dhe OSHC-të do të zbatohet për të promovuar dhe pilotuar qasje dhe praktika të reja në turizmin e bazuar në natyrë dhe menaxhimin e PPNJ-ve (Produkteve Pyjore Jo-Drusore) në kontekstin e "Kornizës së 4 Rikthimeve" (4 Return Framework). Kjo do të shoqërohet me aktivitete ndërgjegjësimi dhe ngritje kapacitetesh, duke lehtësuar pjesëmarrjen lokale në ruajtjen e natyrës dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore për mbrojtjen e biodiversitetit, si dhe krijimin e mekanizmave efektivë të qeverisjes.

CNVP është një organizatë autonome dhe jo-politike, prandaj nuk do të mbështesë, marrë pjesë ose ndërhyjë në asnjë fushatë politike në emër të ose në opozitë me ndonjë kandidat për post publik.

Ky manual ofron kornizën për skemat e nën-grantimit të projektuara për të mbrojtur biodiversitetin dhe promovuar një bioekonomi të qëndrueshme në Parkun Kombëtar Mali Sharr në Maqedoninë e

Veriut. Programi financohet nga Prespa Ohrid Nature Trust (PONT) dhe zbatohet nga Connecting Natural Values and People (CNVP) në Maqedoninë e Veriut.

2. Rajoni i projektit

Skema e nën-grantimit në kuadër të projektit "PULSE - Mbrojtja e Peizazheve dhe Specieve Unike në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut" do të mbështesë aksionet në mikro-rajonin e quajtur 5V (pesë fshatrat) brenda rajonit të Parkut Kombëtar Mali Sharr në Maqedoninë e Veriut, duke targetuar pesë fshatra: Shipkovicë, Vejçë, Brodec, Veshallë dhe Bozofcë.

Tabela e mëposhtme tregon në mënyrë vizuale aksionet që do të ndërmerren në këto zona të mbrojtura.




Fig. 1. Mikro-rajoni 5V në Parkun Kombëtar Mali Sharr

3. Objektivat

Objektivi Përgjithshëm është të kontribuojë në bioekonomi që është ruajtja afatgjatë e biodiversitetit dhe zhvillimi i qëndrueshëm në Parkun Kombëtar Mali Sharr në Maqedoninë e Veriut, përmes fuqizimit të aktorëve lokalë për të udhëhequr ruajtjen e habitateve dhe të specieve, promovimit të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore rreth zonave të mbrojtura strikte (no-take zones), si dhe forcimit të turizmit të bazuar në natyrë si një motor si për mbrojtjen e mjedisit ashtu edhe për mjete jetese të dinjtitshme lokale, në përputhje me planet e menaxhimit të Parkut Kombëtar Mali Sharr në Maqedoninë e Veriut.

Objektivat specifike të projektit përfshijnë:

- Përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore për mbrojtjen e biodiversitetit, ruajtjen e habitateve, zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e njohurive teknike (know-how).
- Diversifikimin e shërbimeve dhe produkteve të turizmit të bazuar në natyrë për të përmirësuar mjetet e jetesës lokale në zonat pilot.
- Përmirësimin e qeverisjes me pjesëmarrje për një menaxhim më të mirë të Zonave të Mbrojtura.

4. Grupet e Synuara (Target Groups)

Nën-grantet do t'u ndahen organizatave jo-qeveritare (OJQ-ve) lokale, bizneseve lokale dhe fermerëve individualë brenda mikro-rajonit "5V" të Parkut Kombëtar Mali Sharr në Maqedoninë e Veriut, duke synuar specifikisht fshatrat **Shipkovicë, Veshallë, Brodec, Vejcë dhe Bozofcë**.

Mbështetja për bizneset lokale dhe fermat bujqësore është e kufizuar në aksione grantesh që kontribuojnë në rigjellbërimin e aktivitetit të tyre dhe dëshmojnë një ndikim të matshëm pozitiv mjedisor përmes ruajtjes së biodiversitetit, përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, përmirësimit të eficiencës së burimeve, uljes së ndikimeve mjedisore apo praktikave të tjera të qëndrueshme mjedisore.

Aktivitetet e projektit duhet të realizohen ekskluzivisht brenda mikro-rajonit të caktuar ose të jenë ngushtësisht të ndërlidhura me aktivitete që garantojnë ndikim të drejtpërdrejtë në mikro-rajonin e caktuar 5V, duke siguruar kështu rikthimin e natyrës, rikthimin social, frymëzimin dhe rikthimin financiar ("4 Return Framework").




Fig. 2. Mikro-rajoni, zona e synuar, në Parkun Kombëtar Mali Sharr

5. Procedurat

Skema e nën-grantimit do të realizohet përmes thirrjes së hapur. Thirrja e parë e hapur për aplikim për skemën e nën-grantimit do të shpallet gjatë periudhës 04 Shtator 2026 deri më 05 Tetor 2026. Thirrja do të mirëpresë aplikime nga grupet e synuara që mbështesin përdorimin e qëndrueshëm të Produkteve Pyjore Jo-Drusore (PPNJ), Turizmin e Bazuar në Natyrë (TBN) si dhe mbrojtjen e biodiversitetit dhe ruajtjen e natyrës në mikro-rajonin e caktuar, me specifikimet e detajuara në kërret e pikës 7.

6. Fazat e nën-grantimit

- **Publikimi i mundësisë për grant:** Shpallje (reklamim) e mundësisë për grant përmes rrjeteve sociale dhe faqes zyrtare të CNVP-së, si dhe institucioneve të tjera që janë pjesë e grupit të palëve të interesit. Dërgimi i mesazheve të drejtpërdrejta me email për përdoruesit potencialë të identifikuar në terren, si dhe përmes kanaleve të tjera përkatëse për të arritur te përfituesit potencialë.
- **Sesioni informues:** Më 15 shtator 2026, në Europe House Tetovë, nga ora 11:00 deri në 12:30, do të mbahet një sesion informues, gjatë të cilit kandidatët e interesuar do të informohen në mënyrë të detajuar për rregullat dhe procedurat specifike, si dhe për dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.

- **Pranimi dhe shqyrtimi i aplikimeve:** Pranimi dhe shqyrtimi i aplikimeve nga aplikuesit e interesuar. Aplikimet duhet të përfshijnë detaje rreth projektit, objektivave të tij, rezultateve të pritura, buxhetit dhe planit të zbatimit. Një komitet i pavarur vlerësimi do të përzgjedhë propozim-projektet më të mira që plotësojnë kriteret e pranimi të detajuara më poshtë, bazuar në rëndësinë e tyre për objektivat e projektit, realizueshmërinë, ndikimin dhe qëndrueshmërinë (Shih Shtojcën 1, Shtojcën 2).
- **Përzgjedhja e ngushtë e aplikuesve:** Krijimi i listës së ngushtë të aplikuesve bazuar në kriteret e pranimi dhe cilësinë e propozimeve të tyre.
- **Nënshkrimi i kontratave me përfituesit:** Kontratat ligjore do të nënshkruhen së bashku me një plan monitorimi.
- **Shpërndarja e fondeve:** CNVP do të administrojë financimin e aksioneve të grantit të miratuara në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar të nën-grantit. Përfituesit duhet të dorëzojnë dokumentacionin mbështetës të kërkuar për miratimin e shpenzimeve të pranueshme. CNVP është përgjegjëse për shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar dhe marrjen e vendimit përfundimtar lidhur me financimin e shpenzimeve të pranueshme në konsultim me përfituesin. Pagesat lidhur me aksionet e miratuara të grantit mund të kryhen drejtpërdrejt nga CNVP. Pas përfundimit të investimit, përfituesi duhet të nënshkruajë një **Formular të Transferimit të Pronësisë** që konfirmon dorëzimin dhe transferimin e pronësisë së mejetit/asetit të financuar pas përfundimit të ciklit të projektit.
- **Monitorimi i ecurisë:** Monitorimi i ecurisë së projekteve përmes vizitave të rregullta në terren dhe raporteve të ecurisë nga nën-grantmarrësit.
- **Vlerësimi i rezultateve:** Vlerësimi i rezultateve të projekteve për të përcaktuar ndikimin e tyre real në përdorimin e qëndrueshëm të Produkteve Pyjore Jo-Drusore (PPNJ), Turizmit të Bazuar në Natyrë (TBN) si dhe ruajtjen e biodiversitetit dhe natyrës, si dhe identifikimi i mësimave të nxjerra për mundësitë e ardhshme të granteve.
- **Ndarja e historive të suksessit:** Ndarja e historive të suksessit nga projektet për të frymëzuar dhe motivuar të tjerët të angazhohen në përdorimin e qëndrueshëm të Produkteve Pyjore Jo-Drusore (PPJD), Turizmit të Bazuar në Natyrë (TBN) dhe ruajtjes së biodiversitetit e natyrës.

7. Llojet (tipet) e pranueshme të aksioneve të grantit në mikro rajonin "5V"

Mbështetja me grante sipas kësaj thirrjeje ndahet në tetë lloje të pranueshme aktiviteteve brenda mikro-rajonit "5V", të ndara sipas grupit të synuar të përfituesve. Specifikisht, kategoritë e aksioneve të grantit nga **a) deri në e)** synojnë zhvillimin e bizneseve lokale dhe modernizimin e fermave bujqësore, ndërsa kategoritë nga **f) deri në h)** u alokohen nismave të udhëhequra nga Organizata Jo Fitimprurëse (OJF-të).

Për kategoritë e aksioneve të grantit nga a) deri në e), mbështetja për bizneset lokale dhe fermat bujqësore është e kufizuar në aktivitete që kontribuojnë në rigjellbërimin e veprimtarisë së tyre dhe dëshmojnë një ndikim pozitiv të matshëm mjedisor. Aksionet e pranueshme duhet të kontribuojnë në ruajtjen e biodiversitetit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, përmirësimin e eficiencës së burimeve, uljen e ndikimeve mjedisore ose praktika të tjera të qëndrueshme mjedisore.

Aksionet e mbështetura janë specifikuar më poshtë:

Building a Greener Economic Environment

- a) Përshtatja dhe eko-përmirësimi i mini-qumështoreve në komunitet të pajisura me teknologji të avancuara të përpunimit për higjienën dhe sigurinë ushqimore, me ndikim në mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e burimeve;
- b) Mbështetja e një qendre grumbullimi për PPNJ (Produkte Pyjore Jo-Drusore) si dhe bimë mjekësore e aromatike që gjenden në mikro-rajon – grumbullimi, selektimi dhe përpunimi i qëndrueshëm i produkteve të egra pyjore dhe bimëve mjekësore;
- c) Transformimi dhe modernizimi ekologjik i staneve tradicionale në akomodime autentike për vizitorët dhe kuzhina demonstruese kulinare;
- d) Ngritja e standardeve të bletarisë, furnizimi me pajisje të specializuara për bizneset e bletarisë, modernizimi i praktikave dhe ngritja e standardeve krahasuese të sektorit;
- e) Rikthimi në gjendje të mirë i tokave bujqësore përmes praktikave të qëndrueshme agro-ekologjike dhe kultivimit tradicional të shumëfishtë, si kultivimi i patates tradicionale, fasules së bardhë dhe pemëve frutore lokale;
- f) Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i shpatave të dëmtuara, nisma fokusohet në rikthimin e kësaj zone natyrore të lartësive të mëdha mbidetare;
- g) Rigjallërimi i shtigjeve të ecjes, restaurimi i rrugëve si eko-shtigje me shumë përdorime për bjeshkatarët, ngjitesit e maleve dhe agri-turistët që kalojnë në mikro-rajon;
- h) Promovimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore të mikro-rajonit, si p.sh. promovimi i instrumenteve muzikore me dorë, suvenirëve, gastronomisë lokale, promovimi i ditës së patates tradicionale, fasules së bardhë, etj.;

Skema e nën-grantimit mund të ofrojë mbështetje për aktivitetet e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to:

- Modernizimi, përshtatja dhe përmirësimi i objekteve për përpunimin dhe ruajtjen e qumështit në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore dhe higjienës;
- Përmirësimi i mini-qumështoreve në komunitet përmes prokurimit dhe instalimit të pajisjeve me eficiencë energjetike për grumbullimin, ftohjen, përpunimin, paketimin dhe kontrollin e cilësisë së qumështit, me qëllim minimizimin e mbetjeve të burimeve dhe uljen e gjurmës mjedisore;
- Furnizimi me pajisje të specializuara për të nxitur prodhimin e qëndrueshëm të mjaltit cilësor të malit dhe për të modernizuar praktikën e bletarisë;
- Blerja dhe instalimi i infrastrukturës mbrojtëse për aktivitetet e bletarisë, përfshirë rrethimet mbrojtëse ndaj kafshëve të egra dhe sistemet e monitorimit;
- Ngritja dhe përmirësimi nga aspekti mjedisor i qendrave të grumbullimit për produktet pyjore jo-drusore (PPJD), bimët mjekësore dhe aromatike, përfshirë pajisjet për selektim, tharje, paketim dhe ruajtje, si dhe trajnimet e komuniteteve lokale për grumbullimin e qëndrueshëm të PPNJ-ve dhe bimëve mjekësore e aromatike në zonat e mbrojtura;
- Prokurimi i pajisjeve për përmirësimin e kapaciteteve për përpunimin dhe tharjen e produkteve pyjore jo-drusore dhe bimëve mjekësore e aromatike (Llojet e pajisjeve: pranim, grumbullim dhe ruajtje, përgatitje për selektim, pastrim, larje, tharje, dezinfektim, kalibrim, largim i frutave të dëmtuara, pajisje për prerje, bluarje dhe pajisje të tjera për përgatitje para përpunimit, pajisje për konservim, tharje, ngrirje, pajisje për mbushje, ambalazhim në shishe, paketim dhe markim/etiketime, pajisje për monitorimin e cilësisë, sisteme kontrolli me gjurmueshmëri të pranimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së produktit);

Building a Greener Economic Environment

- Përmirësimi i kapaciteteve për kultivimin organik të produkteve pyjore jo-drusore dhe bimëve mjekësore e aromatike, si dhe përfshirja e të rinjve dhe grave (Ofrimi i trajnimeve, burimeve dhe mbështetjes për komunitetet lokale për t'i ndihmuar ato të zhvillojnë praktika kultivimi të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin, të krijojnë lidhje me tregun dhe të promovojnë praktika të qëndrueshme);
- Prokurimi i pajisjeve për përpunimin dhe prodhimin e ushqimit tradicional nga ofruesit e shërbimeve të turizmit të bazuar në natyrë (pajisje për përpunim: mulli, bluarëse dhe dehidratues; pajisje për prodhim: furra, sobë dhe pajisje kuzhine; pajisje për turizmin e bazuar në natyrë, si pajisje për ecje dhe kampim, pajisje për turizëm aventuresk, pajisje për sporte ujore, vëzhgim të jetës së egër, etj.);
- Rehabilitimi, shënimi, hartëzimi dixhital dhe promovimi i shtigjeve të ecjes, çiklistike dhe eko-turizmit;
- Instalimi i infrastrukturës për vizitorët, përfshirë tabelat informuese, zonat e pushimit, pikat me pamje panoramike (këndet e vëzhgimit) dhe sinjalistikën e sigurisë përgjatë eko-shtigjeve;
- Masat për kontrollin e erozionit, stabilizimin e shpatave dhe mecenat e restaurimit të ekosistemit në zonat e dëmtuara dhe të ndjeshme mjedisore;
- Promovimi i tureve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore për të mbështetur ekonominë lokale dhe ruajtur traditat kulturore. Mund të mbështeten gjithashtu edhe aktivitetet ndërkufitare për promovim;
- Rregullimi/përmirësimi i kapaciteteve private të akomodimit dhe objekteve të ofruesit të shërbimeve turistike/produkteve të bazuara në natyrë (për rregullimin, pajisjen ose renovimin e objektit sipas traditës së zonës);
- Konservimi dhe ruajtja e staneve tradicionale të barinjve dhe shndërrimi i tyre në objekte të ekoturizmit, qendra vizitorësh, njësi akomodimi për mysafirë dhe hapësira për demonstrime kulinare përmes masave të eficiencës energjetike, praktikave të reduktimit të mbetjeve dhe teknologjive për kursimin e ujit.

Kjo është një listë jo-shteruese. Aktivitete të tjera të pranueshme dhe të përshtatshme mund të përcaktohen dhe t'i shtohen thirrjeve të ardhshme.

8. Kërkesat për Bashkëfinancim

Bashkëfinancimi është i **detyrueshëm** për të gjitha propozim-projektet e dorëzuara sipas kësaj thirrjeje. Kërkesat specifike ndryshojnë sipas aplikuesit dhe kategorisë së aksioneve të grantit:

- **Bizneset Lokale & Fermat Bujqësore (Kategoritë a – e):** Aplikuesit që synojnë zhvillimin e biznesit dhe modernizimin e fermës duhet të ofrojnë një bashkëfinancim **minimal prej 30%** në para (cash) nga vlera totale e investimit. Kontributet në natyrë (in-kind) nuk pranohen për këto kategori.
- **Nismat e udhëhequra nga Organizata Jo Fitimprurëse (OJF-të) (Kategoritë f – h):** Aplikuesit duhet të ofrojnë një bashkëfinancim **minimal prej 20%** nga vlera totale e investimit. Ky kontribut mund të ofrohet në para (cash), në natyrë (in-kind), ose si kombinim i të dyjave.

Për të përfshirë kontributet në natyrë (in-kind) në buxhetin e projektit, vlera e tyre monetare duhet të vlerësohet financiarisht. Kjo përcaktohet duke verifikuar çmimin aktual të tregut për mallrat apo shërbimet specifike që po kontribuohen. Kontributet e pranueshme në natyrë nga përfituesit mund të përfshijnë sa vijon:

Building a Greener Economic Environment

- Koha e vullnetarëve: përfituesit mund të ofrojnë kohën e vullnetarëve si bashkëfinancim në natyrë, ku stafi apo anëtarët e tyre ofrojnë vullnetarisht kohën dhe përvojën e tyre për të mbështetur projektin.
- Hapësira e zyrave: përfituesit mund të ofrojnë hapësirë për zyra si bashkëfinancim në natyrë, duke e lejuar ekipin e projektit ta përdorë hapësirën e tyre pa pagesë.
- Pajisjet dhe materialet e punës: përfituesit mund të ofrojnë pajisje dhe materiale si bashkëfinancim në natyrë, duke vënë në dispozicion pajisjet e nevojshme për projektin, si kompjuterë, printera dhe materiale zyrore.
- Ekspertiza: përfituesit mund të ofrojnë ekspertizën e tyre si bashkëfinancim në natyrë, duke ofruar asistencë teknike ose shërbime konsulente për projektin.
- Trajnimi: përfituesit mund të ofrojnë trajnime si bashkëfinancim në natyrë, duke ofruar trajnim për ekipin e projektit ose përfituesit e tij.
- Krahut i punës: përfituesit mund të ofrojnë punë fizike si bashkëfinancim në natyrë, ku anëtarët e grupit kontribuojnë me kohën dhe përpjekjet e tyre për të mbështetur projektin.
- Toka: përfituesit mund të ofrojnë tokë si bashkëfinancim në natyrë, duke lejuar ekipin e projektit të përdorë tokën e tyre për projektin, si për mbjelljen e kulturave apo ndërtimin e infrastrukturës.
- Pajisjet dhe makineritë: përfituesit mund të ofrojnë pajisje dhe makineri si bashkëfinancim në natyrë, duke vënë në dispozicion makineritë e nevojshme për projektin, si traktorë apo sisteme ujitjeje.
- Inputet (materialet bujqësore): përfituesit mund të ofrojnë inpute si bashkëfinancim në natyrë, duke siguruar fara, plehra ose inpute të tjera të nevojshme për projektin.

9. Aplikuesit e pranueshëm për nën-grantim

Kategoritë e mëposhtme të aplikuesve janë të pranueshme për të dorëzuar propozime sipas kësaj thirrjeje, specifikisht për kategoritë e aksioneve të grantit **a) deri e)** të detajuara në pikën 7:

- **Bizneset lokale** të regjistruara si persona juridikë (jo degë) brenda territorit të komunave Tearcë, Jegunovcë, Tetovë, Bogovinë dhe Vrapçisht, me aktivitete të synuara në fshatrat Shipkovicë, Veshallë, Brodec, Vejcë dhe Bozofcë, si dhe të jenë të regjistruara dhe aktive të paktën 12 muaj para datës së publikimit të thirrjes.
- **Fermat bujqësore** të regjistruara si fermë bujqësore pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, me aktivitete bujqësore në fshatrat Shipkovicë, Vejcë, Brodec, Veshallë dhe Bozofcë.

Kategoritë e mëposhtme të aplikuesve janë të pranueshme për të dorëzuar propozime sipas kësaj Thirrjeje, specifikisht për nismat (llojet e aksioneve të grantit) **f) deri h)** të detajuara në pikën 7:

- **Organizatat Jo Fitimprurëse (OJF-të)** të regjistruara si organizata jo-fitimprurëse (jo degë), sipas Ligjit për Shoqatat dhe Fondacionet të Republikës së Maqedonisë së Veriut, brenda territorit të komunave Tearcë, Jegunovcë, Tetovë, Bogovinë dhe Vrapçisht, me synim fshatrat Shipkovicë, Veshallë, Brodec, Vejcë dhe Bozofcë, si dhe të jenë të regjistruara dhe aktive të paktën 12 muaj para datës së publikimit të thirrjes.

E rëndësishme:

- Aplikuesit në të cilët stafi përkatës i ZM-ve (Zonave të Mbrojtura) është i përfshirë si anëtar i organeve të qeverisjes dhe menaxhimit, ose vepron si staf/ekspert, nuk janë të pranueshëm për të aplikuar.

Building a Greener Economic Environment

- Aplikuesit që aktualisht janë duke zbatuar projekte të financuara nga PONT nuk janë të pranueshëm për të aplikuar në këtë thirrje.

Përfundim nga ky rregull: Aplikuesit, projektet e të cilëve të financuara nga PONT përfundojnë përpara skadimit të thirrjes aktuale për aplikim, janë të pranueshëm për të aplikuar.

10. Aktivitetet e papranueshme

Zëri / Pika	Shenjë kontrolli
Çfarëdo veprimi që çon në ose kërkon shkatërrimin [1] e habitateve kritike [2], ose çfarëdo programi pylltarie që nuk zbaton një plan për përmirësimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm.	
Çfarëdo aktiviteti që mund të lidhet me dëmtimin e konsiderueshëm të zonave që gëzojnë mbrojtje të veçantë (pa kompensim të mjaftueshëm në përputhje me standardet ndërkombëtare).	
Tregtia e kafshëve, bimëve ose çdo produkti natyror që nuk është në përputhje me dispozitat e Konventës për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara të Faunës dhe Florës e Egër (CITES) / Konventës së Uashingtonit [3].	
Metodat e dëmshme/shkatërruese të peshkimit.	
Operacionet e prerjes komerciale të drurit për përdorim në pyjet primare.	
Prodhimi ose tregtia e drurit apo produkteve të tjera pyjore që nuk rrjedhin nga pyje të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme.	
Ndryshimet në shkallë të gjerë dhe të konsiderueshme në përdorimin e burimeve natyrore (p.sh. përdorime të tjera të tokës: si tokë bujqësore, tokë pyjore ose kullotë, për zhvillimin rural, për dru komercial etj.), si dhe bonifikimi i tokës në shkallë të gjerë.	
Ndryshimet në shkallë të gjerë dhe të konsiderueshme në metodat e kultivimit në bujqësi dhe peshkim (p.sh. futja e bimëve të reja, mekanizimi në shkallë të gjerë, futja e llojeve të reja të peshqve), si dhe prerja e drurëve në shkallë të gjerë.	
Përdorimi i burimeve ujore (p.sh. digat e mëdha dhe strukturat e tjera të akumulimit të ujit, impiantet e pompimit dhe depozitimit ose centralet elektrike, projektet e ujitjes dhe kullimit, pusët e thella, menaxhimi i ujërave dhe menaxhimi i zhvillimi i baseneve ujëmbledhëse, furnizimi me ujë, impiantet e çkripëzimit të ujit të detit).	
Infrastruktura (p.sh. rrugët, urat, aeroportet, melet/portet, linjat e transmetimit, tubacionet, rrjetet hekurudhore, transporti tjetër hekurudhor, turizmi).	
Prodhimi i energjisë (p.sh. parqet e mëdha të erës dhe diellore, sistemet e biomasës, impiantet gjeotermale, centralet termike).	
Aktivitetet industriale (p.sh. shkrirësit e metaleve, impiantet e përpunimit të drurit, fabrikat kimike, fabrikat e çimentos, rafineritë dhe impiantet petrokimike, agro-industritë).	

Përdorimi i burimeve gjeologjike, minierat dhe të tjera (p.sh. minierat dhe guroret).	
Menaxhimi dhe asgjësimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura (p.sh. sistemet e ujërave të ndotura dhe impiantet e trajtimit, vendgrumbullimet e mbetjeve/landfillet, impiantet e ripërpunimit për mbetjet shtëpiake dhe mbetjet e rrezikshme).	
Aktivitetet që përfshijnë forma të dëmshme ose shfrytëzuese të punës së detyruar [4] ose punës së dëmshme të fëmijëve [5].	
Programet që përfshijnë zhvendosje fizike të padëshiruar dhe/ose dëbim me forcë.	
Prodhimi ose aktivitetet që cenojnë tokat në pronësi ose të kërkuara me vendim gjyqësor nga Popujt Indigjenë, pa pëlqimin e plotë dhe të dokumentuar të këtyre popujve.	
Prodhimi, përdorimi, shitja ose tregtia e produkteve farmaceutike, pesticideve/herbicideve, substancave që dëmtojnë shtresën e ozonit [6], dhe materialeve të tjera toksike [7] ose të rrezikshme si azbesti ose produktet që përmbajnë PCB [8], kafshët/bimët e egra ose produktet e rregulluara sipas CITES-it, përfshirë të gjitha produktet që janë të ndaluara ose po hiqen gradualisht nga përdorimi në nivel ndërkombëtar.	
Prodhimi ose tregtia e armëve, municioneve, mjeteve luftarake, armëve kontroverse ose përbërësve të tyre (p.sh. armët bërthamore dhe municionet radioaktive, armët biologjike dhe kimike të dëmtimit në masë, bombat me shpërthim të dyfishtë/kasetore, minat kundër njeriut, uraniumi i pasuruar).	
Prokurimi i armëve të zjarrit.	
Ofrimi i financave për institucionet ushtarake të përfshira në aktivitete të ruajtjes së natyrës ose sigurisë.	
Prodhimi ose tregtia e alkoolit të fortë të destinuar për konsum njerëzor ose pijeve të tjera alkoolike (me përjashtim të birrës dhe verës).	
Prodhimi ose tregtia e duhanit.	
Lojërat e fatit, ndërmarrjet e lojërave të fatit, kazinotë ose çdo ndërmarrje dhe veprimtari e barsvlershme [9].	
Çdo tregti që lidhet me pornografinë ose prostitucionin.	
Prodhimi ose tregtia e materialeve radioaktive. Kjo nuk zbatohet për prokurimin e pajisjeve mjekësore, pajisjeve të kontrollit të cilësisë ose aplikimeve të tjera për të cilat burimi radioaktiv është i papërfillshëm dhe/ose i mbrojtur mjaftueshëm.	
Prodhimi ose tregtia e azbestit të palidhur. Kjo nuk zbatohet për blerjen ose përdorimin e veshjeve të çimentos me azbest të lidhur dhe me një përmbajtje azbesti më pak se 20%.	
Prodhimi, tregtia, ruajtja ose transporti i vëllimeve të konsiderueshme të kimikateve të rrezikshme, ose përdorimi i kimikateve të rrezikshme në shkallë komerciale. Kimikatet rrezikshme përfshijnë benzinën, karburantin e rafinuar (vaqellin/kerozinin) dhe produkte të tjera të naftës.	

Tregtia ndërkufitare e mbetjeve, përveç atyre të pranuar nga Konventa e Bazelit dhe rregulloret e saj shoqëruese [10].	
Çdo aktivitet që çon në një modifikim të pakthyesëm ose zhvendosje të konsiderueshme të një elementi të trashëgimisë kulturore me rëndësi kritike [11].	
Prodhimi dhe shpërndarja e, ose investimi në, media që janë raciste, anti-demokratike ose që avokojnë diskriminimin kundër një pjesë të popullsisë.	

11. Dorëzimi i projekt propozimeve

Përmes thirrjes së hapur, aplikuesi do t'i dorëzojë propozimet në mënyrë elektronike (përmes e-mail-it në cnvpmkd@cnvp-eu.org) pranë zyrës së CNVP-së në Shkup, Maqedonia e Veriut. Propozimet duhet të dorëzohen brenda afatit kohor të përcaktuar në thirrjen e hapur. Propozimet e pranuar pas afatit kohor nuk do të merren parasysh.

12. Kriteret e vlerësimit

Procedura për vlerësimin e aplikimit përbëhet nga dy faza: kontrolli administrativ dhe vlerësimi i aplikimeve. Vetëm aplikimet që kalojnë suksesshëm kontrollin administrativ do të vlerësohen nga komisioni i vlerësimit i emëruar nga CNVP.

Gjatë kontrollit administrativ verifikohet plotësia e kushteve të mëposhtme:

- Afati kohor i aplikimit të pranuar.
- Plotësia e aplikimit.
- Plotësia e saktë e aplikimit.
- Nëse janë plotësuar kushtet e pranueshmërisë.

Nëse aplikimi nuk i plotëson këto kushte, ai do të refuzohet dhe aplikuesi do të njoftohet.

Komisioni i vlerësimit i CNVP-së do të vlerësojë propozimet për llojet e aksioneve të grantit **a) deri e)** të detajuara në **pikën 7**, bazuar në kriteret e mëposhtme:

Rëndësia e projektit: 35 pikë	a: Përputhshmëri minimale me objektivat dhe prioritetet e skemës së nën-granteve (0-5 pikë)
	b: Përputhshmëri parciale me objektivat dhe prioritetet e skemës së nën-granteve (6-15 pikë)
	c: Përputhshmëri e fortë me objektivat dhe prioritetet e skemës së nën-granteve, me peshë shtesë për aplikuesit me përvojë të dëshmuar në kontributin për rigjenerimin e tokës, bujqësinë e qëndrueshme, bletarinë ose eko-turizmin brenda mikro-rajonit të Malit Sharr (Shipkovicë, Vejçë, Brodec, Veshallë dhe Bozovcë) (16-35 pikë)
Buxheti: 25 pikë	a: Buxhet i paarsyetuar ose i pamjaftueshëm (0-6 pikë)
	b: Buxhet pjesërisht i arsyetuar dhe i realizueshëm (7-17 pikë)
	c: Buxhet i planifikuar mirë dhe realist (18-25 pikë)
Bashkëfinancimi 25 pikë	a: Kontribut minimal prej 30% në para (0-10 pikë)
	b: Kontribut i konsiderueshëm në para (11-25 pikë)
	a: Pa përvojë përkatëse (0-5 pikë)
	b: Përvojë e mirë përkatëse (6-10 pikë)

Building a Greener Economic Environment

Përvoja përkatëse: 15 pikë	c: Përvojë e gjerë përkatëse (11-15 pikë)
----------------------------	---

CNVP-ja do të vlerësojë propozimet për llojet e aksioneve të grantit **f) deri h)** të detajuara në **pikën 7**, bazuar në kriteret e mëposhtme:

Rëndësia e projektit: 35 pikë	a: Përputhshmëri minimale me objektivat dhe prioritetet e skemës së nën-granteve (0-5 pikë)
	b: Përputhshmëri parciale me objektivat dhe prioritetet e skemës së nën-granteve (6-15 pikë)
	c: Përputhshmëri e fortë me objektivat dhe prioritetet e skemës së nën-granteve, me peshë shtesë për aplikuesit me përvojë të dëshmuar në kontributin për rigjenerimin e tokës, bujqësinë e qëndrueshme, bletarinë ose eko-turizmin brenda mikro-rajonit të Malit Sharr (Shipkovicë, Vejçë, Brodec, Veshallë dhe Bozovcë) (16-35 pikë)
Buxheti: 25 pikë	a: Buxhet i paarsyetuar ose i pamjaftueshëm (0-6 pikë)
	b: Buxhet pjesërisht i arsyetuar dhe i realizueshëm (7-17 pikë)
	c: Buxhet i planifikuar mirë dhe realist (18-25 pikë)
Bashkëfinancimi (në para, në natyrë, apo kombinim i të dyjave): 25 pikë	a: Bashkëfinancim në para / në natyrë të paktën 20% (0-10 pikë)
	b: Kontribut i konsiderueshëm në natyrë / në para (11-25 pikë)
Përvoja përkatëse dhe Referencat: 15 pikë	a: No relevant experience (0-5 points)
	b: Good relevant experience (6-10 points)
	c: Extensive relevant experience (11-15 points)

13. Shpenzimet e pranueshme

Skema e grantit PULSE bazohet në financimin e investimeve direkte dhe në rezultate konkrete. Shpenzimet e pranueshme duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të jenë kryer gjatë zbatimit të marrëveshjes së nën-grantit,
- të jenë të treguara në buxhet,
- të jenë të nevojshme dhe t'u përgjigjen aktiviteve të projektit,
- të jenë të identifikueshme dhe të verifikueshme, në veçanti të jenë të regjistruara në regjistrat kontabël të nën-grantmarrësve,
- të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor dhe shoqëror në fuqi, si dhe
- të jenë të arsyetuara dhe të justifikuar.

13.1 Shpenzimet e pranueshme (të financuara nga CNVP)

Shpenzimet e mëposhtme janë të pranueshme për financim sipas këtij granti:

- Pajisjet dhe makineritë
- Ndërtimi, renovimi dhe përmirësimet e infrastrukturës

Building a Greener Economic Environment

- Materialet dhe lënda e parë (inputs) të nevojshme drejtpërdrejt për investimin
- Shërbimet teknike të lidhura drejtpërdrejt me instalimin ose zbatimin
- Trajnimet e lidhura drejtpërdrejt me përdorimin e pajisjeve të mbështetura dhe çdo gjë tjetër e përmendur në seksionin 7
- Burimet njerëzore janë të pranueshme vetëm për llojet e aksioneve të grantit nga f) deri h), deri në nivelin maksimal prej 15% të shumës totale të projektit

13.2 Shpenzimet e papranueshme (që nuk financohen nga CNVP)

Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të pranueshme veçanërisht për llojet e aksioneve të grantit **a) deri e)** të detajuara në pikën 7:

- Pagat, honoraret ose çfarëdo kosto tjetër e Burimeve Njerëzore
- Kostot indirekte ose operative/s administrative (qira, shërbime komunale, shpenzime administrative)
- Kostot e përgjithshme operative ose të funksionimit
- Kostot që nuk lidhen drejtpërdrejt me aksionin e grantit

13.3 Blerja e pajisjeve/makinerive dhe llojeve të tjera të aksioneve të grantit, për projektet në kategorinë e llojeve të aksioneve të grantit **a) deri e)** të detajuara në pikën 7, do të bëhet ekskluzivisht në bashkëpunim me CNVP Maqedonia e Veriut. Çdo blerje e pajisjeve/makinerive dhe furnizimeve të tjera nga grantmarrësit, do të miratohet paraprakisht nga CNVP Maqedonia e Veriut.

Aktivitetet dhe blerjet që lidhen me llojet e aksioneve të grantit **f) deri h)** të detajuara në pikën 7, do të zbatohen drejtpërdrejt nga grantmarrësit.

Sqarim mbi bashkëfinancimin:

E rëndësishme: Çdo kosto e kryer para datës zyrtare të fillimit të marrëveshjes ose pas përfundimit të marrëveshjes konsiderohet kosto e papranueshme dhe nuk do të financohet.

14. Kontraktimi

Nën-grantet do t'u jepen aplikuesve të suksesshëm bazuar në vlerësimin e propozimeve të tyre. CNVP do të nënshkruajë një kontratë me aplikuesit e suksesshëm, e cila do të përcaktojë kushtet dhe rregullat e nën-grantit.

15. Raportimi dhe Monitorimi

Grantmarrësit do të kërkohet të dorëzojnë raporte periodike të ecurisë pranë CNVP-së. Gjithashtu do të zhvillohen vizita monitoruese për t'u siguruar që grantmarrësit po i zbatojnë aktivitetet sipas propozimit.

16. Ankesat

Për çdo ankesë që lidhet me procesin e përzgjedhjes, Politika e Ankesave e CNVP-së, siç tregohet në linkun e mëposhtëm, do të ketë përparësi (do të prevalojë).

<https://cnvp-eu.org/wp-content/uploads/2026/06/Complaint-policy.pdf>

17. Shtojcat

Building a Greener Economic Environment

Shtojca 1 - Formulari i Aplikimit

Shtojca 2 - Formulari i Buxhetit

Korniza Kohore Indikative	Data
Shpallja e thirrjes	04 Shtator 2026
Sesionet informuese	15 Shtator 2026
Afati i fundit për pyetje dhe kërkesa për sqarime	21 Shtator 2026
Afati i fundit për aplikim	05 Tetor 2026